

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Analiza e The Economist: Pse Rusia po e dobëson qëllimisht monedhën e saj?
ADRESA	https://dosja.al/bota/analiza-e-the-economist-pse-rusia-po-e-dobeson-qellimisht-monedhen-e-saj-i513993
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 05:32:11 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 05:21:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1e771e4e1152bcd43d40e163639354221dc94eb5b090f99f21b53f8bf898e656
TEKSTI	b7637ca436a0546d7e3c16f7f388c3f523329dd4ff0eba1fac74ba6a6fa78272
PAMJA	1cd63f09f079527b64476345671436c7bbe6906438a5aafe328747b37ed2c381

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	95a653fba4a6b818d9803de64766030cfa14f51732d483e4bfcd154746e72cfc
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	ffd91b584b7f6ad6fe6fe6255283fcbda7dbe303bf00ea6d85b435b755931683
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/95a653fba4a6b818d9803de64766030cfa14f51732d483e4bfcd154746e72cfc>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

12 ORE ME PARE

Dita e 106-të e protestës/ Qytetarët zbrasin sërish në shesh, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama: Ju erdhi fundi!

13 ORE ME PARE

Reforma e re territoriale/ Rama përplasht me banorët e Poliçanit dhe kryebashkiakun socialist Adriatik Zotkaj: Qepeni gojën

18 ORE ME PARE

Të shtëna me armë zjarri në Mat/ Gjendet e djegur makina e autorëve, shënjestra ishte Akil Lleshi, makina e të birit u qëllua me 35 plumba

19 ORE ME PARE

"Vetë zot, vetë shkop"/ Ngërçi me pagat e gjyqtarëve, shpërthen Rama: Do nxirrnin dhembët për të shumëfishuar rrogat! KLP e KLGJ, shëmbëlltyra e errët e reformës në drejtësi

Bota

Analiza e The Economist: Pse Rusia po e dobëson qëllimisht monedhën e saj?

Një monedhë më e fortë nënkupton importe më të lira, inflacion më të ulët dhe më pak presion mbi normat e interesit; një monedhë më e dobët sjell të kundërtën.



14 Shtator 2026, 07:21
Nga E.d



Foto ilustruese

RUSI- Qeveritë dhe bankat qendrore zakonisht këmbëngulin se duan një monedhë të fortë. Por jo Rusia, të paktën për momentin. Më 5 gusht, Ministria e Financave njoftoi se do të rriste me rreth 20% blerjet e përditshme të valutave të huaja dhe të arit, nga 5.4 miliardë rubla (69 milionë dollarë në atë kohë) në korrik, në 6.5 miliardë rubla.

The Economist shkruan se Rubla u dobësua siç pritej, nga rreth 80 rubla për dollar në fillim të gushtit në 85 rubla nga mesi i muajit, niveli më i ulët që nga marsi.

Një monedhë më e fortë nënkupton importe më të lira, inflacion më të ulët dhe më pak presion mbi normat e interesit; një monedhë më e dobët sjell të kundërtën. Siç e dinë mirë rusët, një rënie e papritur e monedhës mund të shkaktojë panik financiar, siç ndodhi pasi vendi pushtoi Ukrainën në shkurt 2022 dhe vendet perëndimore vendosën sanksione.

Në pak më shumë se dy javë, Rubla humbi dy të pestat e vlerës së saj kundrejt Dollarit. Rusët nxituan të blinin valutë të huaj dhe të tërhiqnin para nga bankat, një pjesë të madhe të të cilave e shpenzuan për mallra konsumi afatgjatë dhe produkte të tjera.

Por së fundmi, një Rubël e fortë është kthyer në problem — veçanërisht për buxhetin federal. Në gjysmën e parë të vitit, kursi mesatar ishte 77 rubla për dollar, ndërsa buxheti ishte hartuar duke supozuar një kurs prej 92 rublash për dollar.

Meqenëse eksportuesit rusë të naftës, të cilët në pjesën më të madhe janë në pronësi të shtetit ose të lidhur në forma të tjera me qeverinë, i sigurojnë të ardhurat në dollarë, këto të ardhura, të konvertuara në rubla, rezultuan më të ulëta nga sa ishte parashikuar. Nafta dhe gazi sigurojnë 20% të të ardhurave buxhetore.

editoriale

Irena Beqiraj

Fashizmi nuk duhet
kërkuar tek revolta e
protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

Në vëmendje

BOTA 14 SHTATOR 2026, 07:21

Analiza e The Economist: Pse Rusia po e dobëson qëllimisht monedhën e saj?

AKTUALITET 14 SHTATOR 2026, 07:19

BE ka dhënë 1.1 milionë leje
qëndrimi për shqiptarët, në
Gjermani numri arrin rekordin
e 124 mijë

Sa (shtrenjtë) kushton dita e parë e shkollës? Mesatarisht 34 mijë lekë për një fëmijë...

Sigurisht, lufta në Gjirin Persik, duke penguar qarkullimin në Ngushticën e Hormuzit dhe duke çrregulluar shpërndarjen globale të naftës, i ka shtyrë çmimet e naftës në rritje: në gjysmën e parë të vitit, çmimi mesatar i naftës që qeveria përdori për llogaritjen e taksave ishte 68 dollarë për fuçi, kundrejt 59 dollarëve të parashikuar në buxhet.

Megjithatë, të ardhurat nga nafta dhe gazi, prej 3.7 trilionë rublash, ishin 23% më të ulëta se një vit më parë. Vetëm deficit i gjysmës së parë të vitit arriti në 5.7 trilionë rubla, ose 2.5% të PBB-së vjetore, kundrejt 3.8 trilionë rublave (1.6%) të parashikuara për të gjithë vitin. Një Rubël që do të mbetet e fortë do ta zgjeronte më tej këtë hendek.

Krahas dobësimit të Rublës, qeveria po kërkon para edhe nga burime të tjera. Parlamenti rus i ka dhënë Ministrisë së Financave të drejtën të risë huamarrjen përtej kufirit të përcaktuar me ligj, pa pasur nevojë për miratim të mëtejshëm.

Në një qasje më të pazakontë, qeveria u ka kërkuar biznesmenëve rusë të bëjnë kontribute "vullnetare" në buxhetin federal, përfshirë fonde për të ndihmuar në financimin e luftës kundër Ukrainës.

Kjo nismë doli nga një takim në mars me Vladimir Putin, presidentin e Rusisë, ku u diskutua një taksë mbi fitimet e jashtëzakonshme të realizuara në të kaluarën. Që nga fillimi i vitit, drejtuesit e bizneseve kanë derdhur 384 miliardë rubla.

Një rubël më e dobët mund t'i japë njëfarë lehtësimi afatshkurtër buxhetit të Rusisë, por në afat të gjatë, ajo sjell pasojat e zakonshme negative: inflacion më të lartë, importe më të shtrenjta dhe të ardhura reale më të ulëta për familjet.

Norma e inflacionit është rritur tashmë lehtë, në 6% në qershor. Kjo erdhi pjesërisht si pasojë e mungesës së benzinës, e shkaktuar nga sulmet ukrainase ndaj infrastrukturës ruse të naftës. Megjithatë, një Rubël më e dobët mund ta shtyjë inflacionin edhe më lart./Dosja.al

rusi

monedha

renie

Sondazh

Poll

më të klikuarat

"Qepeni gojën"/ Debate për shkrirjen e bashkisë, Rama përplaslet me banorët e Policanit dhe kryebashkiakun socialist Adriatik Zotkaj! Qytetarët largohen nga takimi

Nga "Taken" te Thethi/ TikTokeri, me 4 milionë ndjekës, që i tregoi botës një Shqipëri tjetër

Të shtëna me armë zjarri në drejtim të një automjeti, gjendet e djegur edhe një makinë

Zgjedhjet në Suedi/ E djathta ekstreme synon pushtetin për herë të parë

insights

Ola Xama

Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari

Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka

Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

Fjola Graçi

REPUBLIKA E TRUPROJAVE/ Nga tokat te klubet VIP: Rrjoll, Zvërnec, Sarandë e Ksamil nën hijen e "burrave të zinj"

Moti

Powered by  tomorrow.

Beta

13 Shtator 2020, 22:14

"SHBA nuk mund të mbetet pas Kinës"/ Trump kundër kufizimit të AI: Kush fiton inteligjencën artificiale, fiton mbi të gjithë

Donald Trump SHBA- Presidenti amerikan, Donald Trump ka kritikuar ata që kërkojnë ngadalësimin e zhvillimit të inteligjencë&eu...

VIDEO/ Përfshihet nga zjarri një pyll në Spanjë, plagosen dy persona

Beta

13 Shtator 2026, 20:26

Kthesa strategjike pas përmbytjeve në Marok, synohet që 60% e ujit të pijshëm të sigurohet nga deti

Beta

13 Shtator 2026, 18:32

Krizë ekonomike/ Le Monde: Në Los Anxhelos, mijëra amerikanë detyrohen të jetojnë në makinat e tyre

Beta

13 Shtator 2026, 18:20

Houthit godasin Arabinë Saudite, rritet pasiguria për transportin detar në Detin e Kuq

Beta

13 Shtator 2026, 15:19

Beta

13 Shtator 2026, 13:52

Sekuestrohen 1.6 ton kokainë në një anije peshkimi në Karaibe, në pranga katër persona

Pamje nga operacioni BOTË- Marina dhe forcat ajrore të Hondurasit kanë kapur një anije peshkimi që mbante 1.6 ton kokainë në...

"Atmosfera politike para zgjedhjeve në dy lande gjermane" / DW: Në Berlin kryeson CDU-ja, në Mecklenburg-Vorpommern kryeson AfD-ja

Bota

13 Shtator 2026, 13:15

Atentati ndaj aeroportit gjerman/ Gjurmët që çojnë drejt shërbimit sekret rus

Bota

13 Shtator 2026, 13:09

Konflikti Rusi-Ukrainë/ Kushner: Faza të reja në negociatat për Ukrainën mund të njoftohen brenda disa javësh

Bota

13 Shtator 2026, 12:57

AfD thellon avantazhin ndaj konservatorëve të Merz në sondazhet kombëtare, arrin në 29%

Bota

13 Shtator 2026, 11:35

MË SHUMË



dosja

13 Shtator 2026

“Mërgata të na bashkohet, ndryshe
Atdheu do të ngjitet pa shqiptarë”/
Aktivisti Arben Kola: Nga nesër mbledhja
në sheshin “Skënderbej” nis në orën
18:30



Aktivisti Arben Kola: Nga
nesër mbledhja në sheshin
“Skënderbej” nis në orën
18:30



Përplasjet e Ramës me
banorët e Poliçanit, qytetari:
U soll si sulltan, u tha qepen
gojën



Dita e 106-të e protestës/ Nis
marshimi drejt
Kryeministrit: Shqipëria
kërkon revolucion



Rama në Berat: Çfarë lidhje
ka distanca?, ndryshon vetëm
drejtimi vendor

Aktivisti Arben Kola: Nga nesër mbledhja në sheshin “Skënderbej” nis në orën 18:30

Shiko video te tjera



KTHEHU NE KRYE



Dosja.al është një iniciativë gazetarësh të rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vërtetë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email: team@dosja.al

AKTUALITET

POLITIKE

EKONOMI

BOTA

SPORT

Drejtor: Enton Abilekaj

Kryeredaktor: Izmir Akulli

Gazetarë:

Esmeralda Doçi

Emanuela Dida

Elisa Karaj



[KONTAKT](#) [PRIVACY POLICY](#) [COOKIES](#)

MUNDËSCAR NGA  Mediodesk

ART&ARGËTIM

INSIGHTS

EDITORIAL

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.